



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 174/1 Prot.

Elbasan, më 11.2.2026

Lënda: Mbi aktin e këshillit bashkiak.

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” datë 27.10.2016, ndryshuar me ligjin nr.36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut””, datë 18.04.2024, neni 1, pasi verifikuam aktin tuaj nr.7, datë 30.01.2026 "Për Dhënie Ndhime Financiare", ju sqarojmë se;

Referuar shkronjes a) te nenit 8 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” është përcaktuar se; ”Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore: a) verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësave me **karakter normativ** të organeve të vetëqeverisjes vendore”. Ne piken 2 të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” eshte percaktuar se; ”Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësave me **karakter normativ** të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre”.

Referuar neni 1 te ligjit nr.36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” është përcaktuar se; “**Akte me karakter normativ**” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”

Referuar shkronjes a) te pikes 1 te ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, miratuar në datë 30.04.2015 është përcaktuar se; “1. “Akti administrativ”: a) “**Akti administrativ individual**” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;”.

Përsa më siper duke verifikuar aktet tuaja konstatohet se nuk janë të karakterit normativ por janë akte me karakter individual, në këto kushte nuk janë objekt verifikimi ligjshmërie të Prefektit të Qarkut Elbasan. Theksojmë se për këtë kategori aktesh Këshilli Bashkiak Librazhd duhet të përcaktojë kriteret se si do të aplikohet fondi përkatës për dhënien e ndihmës financiare për të evidentuar edhe target grupin i cili do të jetë përfitues i këtij fondi. Ju sugjerojmë se në të ardhmen aktet me karakter individual nuk duhet të depozitohen në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan.

P R E F E K T I

Ilir Bejtja



174
04.2.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.03.02.2026

Nr.685 prot

Nr.7 dt.30.01.2026

“PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore “ neni 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore “,të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” , si dhe në udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “ Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 30.01.2026 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare per familjen Brasha e cila ka ne perberje 4 anetare (minorene) me kryefamiljare Artjola Brasha sipas kërkesës nr.175 datë 12.01.2026 si familje në vështirësi financiare (për mbulimin e shpenzimeve te varrimit te të ndjerin babait te saj i cila ka ndërruar jetë) në vlerën 130,000 lekë .
2. Vlera prej 130,000 leke per familjen Brasha do ti kaloje subjektit Lila I cili ka kryer te gjitha procedurat mortotr sipas fatures bashkengjitur .
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare z.Skender Gega fshati Xhyre Njesia Adm.Hotolisht në masën 100,000 lekë sipas kërkesës me nr .8 prot datë 05.01.2026 deme nga zjarri ne subjekt tregtare (ushqimore).
4. Fondi prej 230,000 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2026 “Ndihmë Financiare “ në strukturën buxhetore si më poshtë:

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
00	1110	01	606	230,000 lekë Ndihmë financiare

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social, Sektori Financës .
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

